



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



A.nr.958/20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE: “Interlab ” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave” me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Komuna e Podujevës, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën: 18 NËNTOR 2020 mori këtë :

V E N D I M

- I. **Hedhet si e jashtë afatshme** ankesa e OE: “Interlab ” SH.P.K - Prishtinë, me nr. të protokollit. 958/20, e datës: 17 NËNTOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave” me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Komuna e Podujevës.
- II. **I LEJOHET** Autoritetit Kontraktues–AK/ Komuna e Podujevës, që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave” me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Komuna e Podujevës përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 17 NËNTOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE: "Interlab" SH.P.K – Prishtinë, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokollit: 958/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave" me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Komuna e Podujevës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE: "Interlab" SH.P.K – Prishtinë, me nr. të protokollit: 958/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave" me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Komuna e Podujevës, dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si dhe në platformën e-prokurimi kjo ankesë rezulton të jetë e jashtëafatshme sepse është parashtruar në ditën e hapjes së ofertave dhe jo 5 ditë para hapjes sipas LPP-së duke u thirrur që ka parashtruar Kërkesë për sqarime shtesë por AK nuk i ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave

Nga se Autoriteti Kontraktues (AK) "Kuvendi Komunal i Podujevës" për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për nevoja të shkollave" me nr. prokurimit: 615-20-6473-1-1-1. Hapja e Ofertave më datë 17.11.2020.

Operatori Ekonomik ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim më datë 17.11.2020 në ditën e hapjes dhe jo 5 ditë para hapjes sipas LPP-së duke u thirrur që ka parashtruar Kërkesë për sqarime shtesë por AK nuk i ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave. AK nuk i ka kthyer përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim me qen se i ka pasur edhe 3 ditë afat për të kthyer përgjigjeje Operatori Ekonomik ka parashtruar ankesë në OSHP më datë 17.11.2020.

Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pasur parasysh faktin se kërkesa për rishqyrtim duhet të bëhet së paku 5 ditë pas pranimit të Letrës Standarde dhe Njoftimit mbi vendimin e AK-se dhe se afati për paraqitje të Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka përfunduar ende.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE: "Interlab" SH.P.K – Prishtinë OE Ankues nuk ka pritur përgjigjen nga AK dhe ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim në ditën e hapjes dhe jo 5 ditë para hapjes sipas LPP-së duke u thirrur që ka parashtruar Kërkesë për sqarime shtesë por AK nuk i ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave kurse AK nuk i ka kthyer përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim me qen se i ka edhe 3 ditë afat për të kthyer përgjigjeje, andaj ankesa e datës 17.11.2020 me numër të protokollit 958/20, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e jashtëafatshme.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diele ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi shqyrtues i prokurimit sqaron se neni 4 pika a) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së:

Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar

nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: "Interlab " SH.P.K – Prishtinë, e datës 17.11.2020 me numër të Protokollit 958/20, hedhet si e jashtë afatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 4 pika a dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e jashtë afatshme dhe nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Kuvendit Komunal Podujevë,
- 1x1 OE "Interlab " SH.P.K – Prishtinë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së